

**STATUT**  
**I**  
**Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“IREN PHARMA 2020”**



**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1.1. Sot, më 05 /08/2019 (IDymijë e Nëntëmbëdhjetë), ne, themeluesit, krijuam një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“IREN PHARMA 2020” SH.P.K.**
- 1.2. Themelues të shoqërisë janë:
  - 1. Z. Stavros Papathanasioy**, i biri i Vasileios dhe Sevasti, i datëlindjes 22.05.1980, lindur dhe banues në Janinë Greqi, shtetas grek, mbajtës i Kartës së Identitetit greke me Nr. **AH738341**.
  - 2. Znj. Irini Zoi** : e bija Jorgo dhe Thanasula, datelindjes 10.05.1969, lindur Rabije Tepelene, banues në Gjirokastër, mbajtës i kartës së identitetit G95510164J.

**Neni 2**  
**Objekti**

- 2.1 Objekti i aktivitetit të shoqërisë, pa u kufizuar në të, do të jetë:

export-import të produkteve farmaceutike, parafarmaceutike, kozmetike, ortopedike, optike..etj  
tregti me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutike, parafarmaceutike kozmetike, ortopedike, optike..etj.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 99 vjet.

**Neni 4:**  
**Selia**

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: “Rruga “18 Shtatori”, Lagjja “18 Shtatori”, godinë 2-katëshe, kati i parë, nr. pasurie 16/88-N3, Zona Kadastrale 8541, Gjirokastër”.

## KREU II KAPITALI

### Neni 5 Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1.200.000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

**1. Z. Stavros Papathanasioy**, zotëruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.188.000 lekë që përbën 99% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**2. Znj. Irimi Zoi**, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 12.000 lekë që përbën 1% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5.2 Kontributi I ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

### Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit

6.1 Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet në permjet nënshkrimit të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Ortakët e shoqërisë I vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjellta me njëri-tjetrin dhe I shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.


6.3 Zvogëlimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi I prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### Neni 7 Transferimi I kapitalit

7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.




7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarrës**

- 8.1 Asambleja e Ortakeve është organi I vetëm vendimmarrës I shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve është organi I vetëm vendim marrës I shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
  - ç) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - gj) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Ortakeve, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person I tretë.
- 8.5 Administratori I shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues I ortakëve në Asamblenë e Ortakeve.
- 8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Ortakeve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 8.7 Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Ortakeve ushtrohen nga ortaku I vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku I vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit



nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investimet;
- d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

### **Neni 9**


#### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Ortakeve**

- 9.1 Asambleja e Ortakeve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara dates së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.2 Kur Asambleja e Ortakeve nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10**

#### **Kërkesa nga ortakët e pakicës**

- 10.1 Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 20 përqind të totalit të votive në Asamblenë e Ortakeve të shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Ortakeve dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat Asambleja e Ortakeve duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin Asamblenë e Ortakeve dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 9 të këtij Statuti.
- 10.2 Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, Asambleja e Ortakeve nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
  - a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse Administratori nuk përmbush kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
  - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tij.
- 10.3 Në rastet kur rendi I ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja I është njoftuar ortakëve, Administratori njofton përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 9 të këtij Statuti.



## **Neni 11 Kuorumi**


- 11.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Ortakeve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.
- 11.2 Në rastin kur Asambleja e Ortakeve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 përqind të kuotave.
- 11.3 Nëse Asambleja e Ortakeve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 12 Marrja e vendimeve**

- 12.1 Asambleja e Ortakeve vendos me tri të katërtat e votive të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.2 Asambleja e Ortakeve vendos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratori, përfshirë përgatitjen e Pasqyrave Financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - dh) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Ortakeve ;
- 12.3 Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKR-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **Neni 13 Përfundim i drejtës së votës**

- 13.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes nëse Asambleja e Ortakeve merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;



- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

13.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një person I autorizuar, I autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### **Neni 14 Administrimi**

- 14.1 Asambleja e Ortakeve emëron një person fizik si Administrator të shoqërisë. Afati I emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi I administratorit prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 14.2 Personi I më poshtëm caktohet si Administrator I pare I shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Ortakeve:

Të dhënat e identifikimit:

- 1. 1. Z. Stavros Papathanasioy**, i biri i Vasileios dhe Sevasti, i datëlindjes 22.05.1980 ,lindur dhe banues ne Janine Greqi, shtetas grek,mbajtës I Kartës së Identitetit greke me Nr.**AH738341**.

#### **Neni 15 Kompetencat e Administratorit**

- 15.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakeve;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisë dhe nënshkruajë Pasqyrat Financiare vjetore dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, I paraqet këto dokumenta përpara Asamblesë së Ortakeve për miratim;
  - d) krijojë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - e) raportojë përpara Asamblesë së Ortakeve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



e) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe në Statut.

15.2 Administratori është I detyruar të thërrasë Asamblenë e Ortakeve, në rastet kur:

- a) sipas Pasqyrave Financiare vjetore apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas rregjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që ka vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

15.3 Asambleja e Ortakeve mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e Administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 16** **Përgjegjësitë e Administratorit**

16.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, përshkelje të ligjeve, përshkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasoja të marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që I sjellin dëm shoqërisë, I ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

16.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit 9901 datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke I kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që I njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

16.3 Administratorit, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe



vlerësimin të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

- 16.4 Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1,2 dhe 3 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e proves për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standard vetë kërkuara.
- 16.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

#### **KREU IV VITI FINANCAR DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

##### **Neni 17 Viti Financiar**

- 17.1 Viti Financiar I Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti I pare Financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

##### **Neni 18 Shpërndarja e fitimeve**

- 18.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
- 18.2 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 18.3 Administratorët lëshojnë një certificate të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e





pikës 2 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk I përmbush këto kritere, Administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

- 18.4 Administratorët përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certificates së aftësisë paguese.



## **KREU V PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 19 Prishjadhelikuidimi**

- 19.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
  - d) me Vendim të Gjykatës;
- 19.2 Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Në këtë rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidues dhe duke shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuiduesit dhe emërtesën shtesë "Shoqërinë likuidim e sipër". Nëse Asambleja e Ortakeve nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person I interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni20 Riorganizmi I shoqërisë bashkimi-ndarja**

- 20.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare."


### **Neni 21 Baza Ligjore**

- 21.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Përsa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarë do ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 22**  
**Mosmarrëveshjet**

- 22.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërise dhe të tretëve, do të zgjidhen nga Gjykata kompetente Shqiptare.

**O R T A K Ë T**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"IREN PHARMA 2020-"**

STAVROS PAPATHANASIOU  






**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA E NOTERISE GJIROKASTER**  
**NOTER GENTIAN E. BINERI**

Nr.896 rep.

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datën 05.08.2019 (Dymijë e nentembedhjetë) dite hene, para meje noter Gentian E. Bineri, noter i Dhomës së Noterëve Gjirokaster, me adrese lagja “18 shtatori” Gjirokaster , u paraqit personalisht pala:

- 1. Z. Stavros Papathanasioy**, i biri i Vasileios dhe Sevasti, i datëlindjes 22.05.1980 ,lindur dhe banues ne Janine Greqi, shtetas grek,mbajtës I Kartës së Identitetit greke me Nr.**AH738341**.
- 2. Znj. Irimi Zoi** : e bija Jorgo dhe Thanasula,datelindjes 10.05.1969,lindur Rabije Tepelene,banues ne Gjirokaster ,mbajtes i kartes se identitetit G95510164J.

Pala më deklaroi se dokumenti bashkangjitur këtij Vërtetim Nënshkrimi është “Statut Shoqerise **IREN PHARMA 2020** sh.p.k.” që është redaktuar jashtë kësaj zyre noteriale nga vete pala me vullnetin e tyre te lire,e te plote dhe u nënshkrua prej te siperpermendurve, ne prezencen e noterit.

Unë noteri vërtetoj nënshkrimin, sipas ligjit nr 110/2018 datë 20.12.2018 “Për Noterinë”

**NOTERI**  
Gentian E. Bineri

